



Numri i Dokumentit Document No.	03.11.2022	viti year	2
Shkronja e Agjencisë Org. Unit	No. Prot. Doc. No.	Shtojca Punig Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SACK	6688/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.814/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqirrii-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.814/2022 të datës 21.09.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër organit të punësimit Thesari i Kosovës, në çështjen juridike-administrative "kompensim material", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.814/2022 e datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Thesarin e Kosovës, me datë 21.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5556/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër përgjigjes së datës 08.09.2022 të Menaxheres së Personelit në Thesarin e Kosovës, për shkak të shkelje ligjore dhe procedurale si dhe shkeljeve të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve. Ndërsa Njësia e Personelit të Thesarit të Kosovës me datë 03.10.2022 ka percjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5556/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të protokollit 6124



të datës 03.08.2022 të ankueses drejtuar Zyrës së personelit të Thesarit të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 08.09.2022 të menaxheres së Personelit të Thesarit të Kosovës; Akt Emërimit e me numër protokollit 5598/2022 të datës 22.09.2022; Vendimin me numër 10/2018 të datës 06.04.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës; Akt Emërimit e datës 12.06.2017; Vendimin me numër protokollit 55 të datës 02.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës; Vendimin me numër 18/2022 të datës 23.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës; Vendimin me numër 21/2022 të datës 15.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës; Emërimi dhe Fletë deponimi i Nënshkrimeve i datës 17.05.2019; Kërkesën (Formular) për Krijim ose Editim të Përdoruesit në SIMFK të datës 12.01.2022; Patent Shoferin e ankueses; Certifikatën e Trajnimit të datës 05.2012 për General Ledger; Certifikatën e Trajnimit të datës 05.2012 për Commitments; Certifikatën e Trajnimit të datës 05.2012 për Purchasing; Certifikatën e Trajnimit e datës 05.2012 për Expenditures; Certifikatën e Trajnimit të datës 05.2012 për Payments; Kërkesë (Formular) për Krijim ose Editim të Përdoruesit në SIMFK të datës 01.02.2021; ID-në e Resmije Salihu-Rexhepi; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5649/2022 të datës 23.09.2022; Përgjigje në kërkesë me numër të protokollit 5829/2022 të datës 03.10.2022; Vendimin me numër 24/2019 të datës 24.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 02.03.2021; Katalogun e Vendeve të Punës të datës 05.02.2015; Vendimin me numër 05/12 të datës 05.02.2015 nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Kartela e nëpunësit të datës 30.09.2022; E-mail Zyrtar i datës 28.09.2022 nga Thesari i Kosovës; Vendosja e Koeficientit me numër 6038 të datës 27.11.2014 nga Ministria e Administratës Publike; E-mail zyrtar i datës 30.09.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; E-mail zyrtar i datës 28.09.2022 nga Ministria e Financave;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të çështjes, Kolegji ka gjetur së ankuesja është e punësuar në Thesarin e Kosovës përkatësisht sipas Akt emërimit të datës 01.06.2017 ankuesja është emëruar në pozitën e punës "Analiste e Lartë Financiare", me koeficient tetë (8) të pagës. Të njëjtës në bazë të Vendimit nr.16/2019 të datës 30.04.2019 dhe Nr.24/2019 të datës 24.06.2019 të Drejtorit të Thesarit të Kosovës i janë deleguar detyra shtesë duke u caktuar si zyrtar përgjegjës alternativ për aprovimin e pagesave në ndërlidhje direkte me Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave Publike (SIMFK) dhe sistemit të pagave të Bankës Qendrore të Kosovës.

Me datë 03.08.2022 ankuesja ka parashtruar kërkesë pranë organit të punësimit për harmonizimin koeficientit nga tetë (8) në nëntë (9) lidhur me pozitën Zyrtar Certifikues. Ndërsa, në përgjigje të kërkesës së ankueses Menaxherja e Personelit në Thesarin e Kosovës me datë 08.09.2022 ka njoftuar të njëjtën së lidhur me kërkesën në fjalë Thesari i Kosovës nuk mund të ndërmarr ndonjë veprim deri sa të miratohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Thesarin e Kosovës, pastaj realizimin e buxhetimit të mjeteve sipas rregullores së re, si dhe miratimi i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, i cili është në proces të zhvillimit të konsultimeve para miratimit përfundimtar të tij.

Kundër përgjigjes së datës 08.09.2022 të Menaxheres së Personelit në Thesarin e Kosovës ankuesja me datë 21.09.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e cila për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale si dhe shkelje të ligjit material, duke propozuar



Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të obligoj Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës që bëjë ndryshimin e koeficientit të pagës nga tetë (98) në nëntë (9) si dhe kompensimin në mënyrë retroaktive nga data e emërimit deri në zbatimin e këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, i'u referua nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", si dhe nenit 3 të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin shprehimisht është paraparë se: "1.E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë", dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në provat e çështjes, Kolegji konstaton se ankuesja sipas Akt të Emërimit në fuqi (të datës 01.06.2017) është e emëruar në pozitën *Analiste e Lartë Financiare*, ndërsa me Vendimet nr.16/2019 të datës 30.04.2019 dhe Nr.24/2019 të datës 24.06.2019 të Drejtorit të Thesarit të Kosovës është caktuar si zyrtare përgjegjëse alternative e jo si zyrtare e rregullt për aprovimin e pagesave si detyra në fushëveprimin e Zyrtarit Certifikues, kështu që mbi këtë bazë Kolegji vlerëson së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankueses për harmonizimin e koeficientit të pagës nga tetë (8) në nëntë (9) lidhur me pozitën zyrtar certifikues.

Nisur nga qëllimi i ankesës, Kolegji po ashtu konstaton së kompensimi lidhur me punët shtesë të deleguara për nëpunësin civil, mund të behët vetëm në pajtim me shtesat dhe kompensimet tjera të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr. Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.814/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit të Thesarit të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.